



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR LITUANINË

1. Informacion bazë

- a) Kryeqyteti: Vilnius
- b) Popullsia: 3.369.600
- c) Sipërfaqja: 65.200 km²
- d) Monedha: Lita Lituanëze (Lt) (1/100 centas); 1 Euro = 3.45280 Lt
- e) Niveli i papunësisë: 4.5%

2. Kushtet e përgjithshme të hyrjes dhe informacion për vizat

Vizat lëshohen nga misionet diplomatike dhe zyrat konsullore të Republikës së Lituanisë. Nëse nuk ka misione diplomatike ose zyra konsullore lituanëze në vendin tuaj, ju lutemi të aplikoni në misionin/zyrën më të afërt ose më të përshtatshme për ju.

Vizat tranzit (A, B):

Viza aeroportuale (A) ju lejon të kaloni nëpër një aeroport ndërkombëtar në zonën e Shengenit pa hyrë në territorin e Shengenit. Shtetasit nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia nuk kanë nevojë për vizën aeroportuale (A).

Viza tranzit (B) lëshohet për një periudhë pesë-ditore për të kaluar nëpër territorin e Shengenit me rrugë tokësore.

Viza Shengen për qëndrim afatshkurtër (C):

Meqenëse Lituania është një Vend Anëtar i Marrëveshjes Shengen, viza për hyrje në Lituani i jep të drejtën personit për të hyrë në të gjithë zonën Shengen. Viza për qëndrim afatshkurtër (C) i lejon personit të qëndrojë deri në 90 ditë në territorin e Shengenit gjatë një periudhe të caktuar 180-ditore për qëllime turizmi, familjare ose tregtare.

Shtetasit kroatë nuk kanë nevojë të aplikojnë për vizën e qëndrimit afatshkurtër (C). Shtetasit nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia i nënshtrohen kërkesës për vizë. Mbi bazën e Marrëveshjeve për Lehtësimin e Vizave dhe për Ripranimin ndërmjet BE-së dhe **Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë**, shtetasit e këtyre vendeve vazhdojnë të kenë nevojë për vizë Shengen C për të hyrë në Lituani; megjithatë, ata përfitojnë një tarifë të reduktuar për lëshimin e vizës (35 Euro dhe jo 60 Euro). Shumë kategori aplikantësh (pjesëtarë familjesh të shtetasve me qëndrim të ligjshëm, studentët dhe pensionistët, gazetarët, etj.) tani mund të përfitojnë viza pa pagesë.

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Ndërtimi i Kapaciteteve, Informacion dhe Ndërgjegjësim për Promovimin e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin, Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria Italiane e Punëve të Jashtme/Bashkëpunimi Italian për Zhvillim dhe Qeveria e Lihtenshtejn.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN

Për kategori të caktuara personash, psh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kriteret për dokumente janë më të thjeshtuara. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (duke përfshirë tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësues të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje që janë të vlefshme për periudha të gjata, ndërsa personat me pasaporta diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Për më shumë detaje, shikoni:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnje-Hercegovinën)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

Për të aplikuar për vizë qëndrimi afatshkurtër (C), ju duhet të paraqisni:

- një dokument të vlefshëm udhëtimi;
- një formular të përcaktuar për aplikimet për vizë Shengen;
- një fotografi 35x45 mm, që përshtatet me moshën e të huajit;
- faturën e pagesës së tarifës konsullore;
- një dokument të vlefshëm që vërteton sigurimin shëndetësor;

Për të marrë vizë afatshkurtër qëndrimi (C) duhet paraqitur një ftesë nga një subjekt fizik apo juridik i Republikës së Lituanisë hartuar në zyrën e migracionit të një komisariati policie. Më shumë informacion mund të gjeni në: <http://www.migracija.lt/index.php?12657589>

Viza për qëndrim afatgjatë (D)

Një vizë me një hyrje (D) mund t'i lëshohet një të huaji, të cilit i është dhënë leja e qëndrimit të përkohshëm ose të përhershëm në Republikën e Lituanisë nga Departamenti i Migracionit në Ministrinë e Brendshme. Një shtetas i huaj që dëshiron të marrë vizë për qëndrim afatgjatë (D) duhet të dorëzojë, ndër dokumentet e tjera, edhe njoftimin e Departamentit të Migracionit për vendimin për të lëshuar leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme në Republikën e Lituanisë.

Ambasadat në Republikën e Lituanisë

Lithuanian Embassy in Greece (covering Albania) Ambasada Lituanëze në Greqi (që mbulon Shqipërinë)

49, Vasilissis Sofias Ave., 10676 Athens

Tel: +30-210-7294356, +30-210-7294357

Fax: +30-210-7294347

Email: amb.gr@urm.lt

Lithuanian Embassy in Hungary (covering Serbia, Bosnia And Herzegovina, Montenegro, the Former Yugoslav Republic of Macedonia) Ambasada Lituanëze në Hungari (që mbulon Serbinë, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë)

Dobsinai utca 4/A, 1124 Budapest

Tel: +36 1 224 79 10

Fax: +36 1 20 23 995

E-mail: litvania@litvania.hu

<http://hu.mfa.lt>

Lithuanian Embassy in Austria (covering Croatia) Ambasada Lituanëze në Austri (që mbulon Kroacinë)

Löeengasse 47/4, 1030 Vienna

Tel: +43 1 718 5467

Fax: +43 1 718 5469 (43 1) 710 97 58

E-mail: amb.at@urm.lt

<http://at.mfa.lt>

3. Imigracioni për arsye punësimi

a) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të punëtorëve të huaj

Një shtetas i cili synon të punojë në Lituani duhet të sigurojë leje pune. Lëshimi i lejeve të punës për të huajt varet nga kërkesa për tregun e punës në Lituani. Leja e punës mund t'i lëshohet një të huaji nëse nuk ka asnjë specialist në Lituani i cili përmbush kriteret për kualifikimet e punonjësit. Leja e punës lëshohet nga Zyra e Shkëmbimit të Punës në Ministrinë e Sigurimit Shoqëror dhe Punës në Republikën e Lituani. Aplikimi për leje pune duhet të paraqitet nga punëdhënësi dhe duhet të shqyrtohet brenda dy muajve nga data e marrjes së aplikimit nga Zyra Lituanëze e Shkëmbimit të Punës. Leja e punës duhet të sigurohet përpara hyrjes në Lituani.

Vlefshmëria e lejes së punës:

- leja e punës lëshohet për një periudhë deri në 2 vjet duke përcaktuar punën (pozicionin) dhe shoqërinë, institucionin ose organizatën ku do të punësohet i huaji;
- i huaji i cili kryen punësim sezonal siguron një leje pune të vlefshme deri në 6 muaj gjatë një viti i cili fillon nga dita e parë e hyrjes në Lituani;
- i huaji i cili vjen në Lituani për një stazh ose training praktik merr një leje pune të vlefshme për një vit, e cila mund të zgjatet në raste të veçanta kur kohëzgjatja e stazhit apo trainimit është më e gjatë dhe ajo nevojitet për të siguruar kualifikimin në një fushë të caktuar

Kush ka të drejtë të punojë pa leje pune në Lituani:

- shtetasit e Bashkimit Evropian
- personat me leje qëndrimi të përhershme
- personat me leje qëndrimi të përkohshme (për arsyt e mëposhtme):
 - personat që kanë ruajtur të drejtën e shtetësisë lituanëze sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin për Nënshetësinë;
 - personat me origjinë lituanëze;
 - personat që janë pranuar në Lituani për arsye të bashkimit familjar;
 - personat në shtëpitë e fëmijës apo të caktuar si kujdestarë;
 - refugjatët dhe personat që kanë marrë mbrojtje plotësuese në Lituani.
- pronarë të bizneseve të regjistruar në Lituani
- drejtues shoqëror
- sportistë profesionistë
- studiues

Për listën e personave që përjashtohen nga ky detyrim, ju lutemi të shihni:

http://www.ldb.lt/LDB_Site/en/index.aspx/en/uzsien_idarbinimas/?menu_id=371

Një të huaji, që nuk është shtetas i një vendi anëtar të BE-së dhe synon të punojë, i lëshohet një leje qëndrimi e përkohshme për një vit. Aplikimi i një të huaji për leje qëndrimi të përkohshme, mund të shqyrtohet bashkë me aplikimin për lejen e punës.

Më shumë informacion, mund të siguroni nga:

LITHUANIAN LABOUR EXCHANGE (ZYRA LITUANEZE E SHKËMBIMIT TË PUNËS)

Geležinio Vilko St 3A, LT-03131 Vilnius

Tel: (+370 5) 236 07 70, fax: (+370 5) 236 07 88

E-mail: info@ldb.lt, <http://www.ldb.lt>

b) sektorët e tregut të punës që po përjetojnë mungesa

Në vitin 2007, në Lituani janë kërkuar specialistë nga fushat e mëposhtme: menaxherë shitjesh, menaxherë shërbimi biznesi, menaxherë sigurimesh, menaxherë publiciteti, menaxherë marketingu, specialistë logjistike, agjentë pronash të patundshme, specialistë finance dhe kontabiliteti, inxhinierë ndërtimi, inxhinierë elektrikë, inxhinierë mekanikë, inxhinierë sistemesh kompjuterike dhe inxhinierë programimi.

Përsa i takon profesioneve të punëtorëve, ka pasur mungesë të personelit ndërtues, përmbarues ndërtimi, suvatus, bojaxhinj, pllakashtrues, karpentierë, teneqexhinj, elektrikistë, hidraulikë, shitës, baristë, kamarierë, kuzhinierë, konfeksionues, rrobaqepës, saldatorë, metalpunues, operatorë mekanerish, zdrukthëtarë dhe mobilierë.

4. Imigracioni për qëllime studime

a) kushtet e hyrjes dhe qëndrimit për studentët

Pasi është pranuar në një institucion për një program studimi në Lituani, studenti duhet të aplikojë për leje qëndrimi të përkohshme në misionin diplomatik lituanes me të afërt (<http://www.urm.lt>). Rekomandohet që aplikimet të dorëzohen të paktën 5-6 muaj përpara fillimit të shkollimit. Për më shumë detaje, ju lutemi të vizitoni http://www.lamabpo.lt/Study_LT.pdf

Një të huaji, që synon të studiojë në Lituani, do t'i lëshohet një Leje Qëndrimi e Përkohshme (LQP) për një vit akademik. Studenti duhet të aplikojë për leje në Ambasadën/Konsullatën lituaneze me të afërt. Personit më pas i jepet një vizë afatshkurtër nga Ambasada, sapo Departamenti i Migracionit në Lituani konfirmon aplikimin e tij/saj për lejen. Karta e lejes së qëndrimit të përkohshëm mund të sigurohet brenda 7 ditëve pas mbërritjes në vendin pritës.

b) listë e universiteteve dhe kolegjeve kryesore

<http://www.smm.lt/en/smt/institutions.htm>

c) programet e studentëve të huaj

Për programet e studimit në gjuhën angleze në Lituani shikoni: http://www.lamabpo.lt/Study_LT.pdf
Programet master në gjuhën angleze në Universitetin e Vilniusit: http://www.vu.lt/en/studies/master_english/
Programet master në Universitetin Kaunas <http://www.vdu.lt/>
Studime në Universitetin Klaipeda http://www.ku.lt/en/study/programs/lt_lang_summer.php
Programet Ndërkombëtare në Universitetin Siauliu <http://www.su.lt/article/archive/1067>

5. Qëndrimi

Leja e qëndrimit të përkohshëm

Leja e qëndrimit të përkohshëm zakonisht lëshohet kur leja e qëndrimit jepet për herë të parë dhe për të duhet të aplikoni pranë zyrës konsullore ose ambasadës me të afërt. Zakonisht ajo lëshohet për 1 vit, por mund të jetë edhe për një kohë më të shkurtër. Duhet të sigurohet një dokument i vlefshëm udhëtimi për të formalizuar lejen e përkohshme, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të paktën tre muaj.

Lejet e qëndrimit për personat me origjinë lituaneze dhe të huajt që kanë të drejtën të marrin shtetësinë në Republikën e Lituani, lëshohen për 5 vjet.

Kush ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi të përkohshëm:

- personat që kanë ruajtur të drejtën e nënshtetësisë në Republikën e Lituani në procedurën e parashikuar nga Ligji për Nënshtetësinë në Republikën e Lituani;
- personat me origjinë lituaneze;
- personat e pranuar në Lituani për arsye të bashkimit familjar;
- personat që synojnë të punojnë në Republikën e Lituani;
- personat që dëshirojnë të kryejnë aktivitete të ligjshme në Republikën e Lituani;
- studentët e ardhshëm
- personat në shtëpitë e fëmijës ose të caktuar si kujdestarë;
- personat që nuk mund të deportohen nga Republika e Lituani sipas procedurës së parashikuar me ligj ose deportimi i të cilëve nga Republika e Lituani është shtyrë;
- personat që kanë përfutur mbrojtje plotësuese në Lituani;

Leja e qëndrimit të përhershëm

Kush ka të drejtë të aplikojë për leje qëndrimi të përhershëm:

- personat që kanë ruajtur të drejtën e nënshtetësisë në Republikën e Lituaniës në procedurën e parashikuar nga Ligji për Nënshtetësinë në Republikën e Lituaniës;
- personat me origjinë lituaneze;
- personat e pranuar në Lituani për arsye të bashkimit familjar;
- personat që e kanë humbur shtetësinë e Republikës së Lituaniës, por që qëndrojnë në Republikën e Lituaniës;
- fëmijët nën moshën 18 vjeç, që kanë lindur ose qëndrojnë në Republikën e Lituaniës, prindërit e të cilëve ose njëri prej të cilëve ka një leje qëndrimi të përhershme;
- refugjatët;
- personat me leje qëndrimi të përkohshme që kanë qëndruar në Lituani pa ndërprerje **5 vitet e fundit**;
- personat e parashikuar në nenin 3 të Ligjit për Zbatimin e Ligjit për Statusin Ligjor të të Huajve në Republikën e Lituaniës.

Për më shumë informacion, kontaktoni me

Migration Department of the Ministry of Interior (Departamenti i Migracionit të Ministrisë së Brendshme)

Šventaragio str. 2, Vilnius, tel.: + 370 52 271 71 12

mdinfo@vrm.lt

6. Procedura e azilit

Format e Azilit

Format e azilit që jepen në Lituani janë si më poshtë:

- 1) statusi i refugjatit
- 2) mbrojtje plotësuese
- 3) mbrojtje e përkohshme

Aplikimi për statusin e refugjatit mund të paraqitet në pikat e kalimit kufitar të Republikës së Lituaniës ose pranë Shërbimit të Mbrojtjes së Kufirit Shtetëror; pranë strukturës policore territoriale ose pranë Qendrës për Regjistrimin e të Huajve.

Gjatë përpunimit të aplikimit për azil, azilkërkuesi do të strehohet në Qendrën për Regjistrimin e të Huajve ose Qendrën e Pritjes së Refugjatëve dhe do të marrë ndihmë ligjore, përkthimi, mjekësore, etj.

Departamenti i Migracionit në Ministrinë e Brendshme merr një vendim në lidhje me përcaktimin e shtetit përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit për azil brenda 48 orëve nga momenti i dorëzimit të aplikimit për azil. Në rast se gjykohet se vendi përgjegjës është një shtet tjetër anëtar i BE-së, autoritetet lituaneze do t'ia transferojnë aplikantin atij shteti anëtar në përputhje me dispozitat e Konventës së Dublinit. Shqyrtimi i aplikimit për azil në nivelin e parë kryhet nga Departamenti i Migracionit në Ministrinë e Brendshme.

Qendra për Regjistrimin e të Huajve është një institucion përgjegjës për mbajtjen dhe strehimin e aplikantëve për azil, për kryerjen e verifikimeve në lidhje me identitetin personal të shtetasve që mbahen apo strehohen në Qendër, rrethanat e hyrjes së tyre në Republikën e Lituaniës, menaxhimin e dosjeve që mbahen për të huajt dhe kryerjen e dëbimeve të shtetasve nga Republika e Lituaniës.

Qendra e Pritjes së Refugjatëve është një institucion buxhetor që ofron shërbime sociale, që kanë për qëllim të strehojnë refugjatët dhe të miturit e pashoqëruar si dhe zbatimin e integritimit social të refugjatëve.

Një i huaj që ka marrë statusin e refugjatit në Republikën e Lituaniës merr lejen e qëndrimit të përhershëm në Republikën e Lituaniës me vendim të Departamentit të Migracionit. Një i huaj, të cilit i është miratuar mbrojtja plotësuese në Republikën e Lituaniës, merr lejen e qëndrimit të përkohshëm me vendim të Departamentit të Migracionit.

Shikoni gjithashtu Ligjin për Statusin Ligjor të të Huajve:

http://www3.lrs.lt/pls/inter3/dokpaieska.showdoc_l?p_id=319034

7. Bashkimi familjar

Bashkëshorti/ja e një shtetasi/e nga një vend jo-anëtar i BE-së (ose personi që ka lidhur një marrëveshje partneriteti me një shtetas nga një vend jo-anëtar të BE-së), fëmijët e pamartuar dhe në varësi të çiftit ose të njërit prej tyre (fëmijët e birësuar) nën moshën 18 vjeç, mund të hyjnë në Lituani për qëllime të bashkimit familjar me të huajin që ka qëndruar në Lituani për një periudhë të vazhdueshme prej të paktën 2 vjetësh.

Azilkërkuesit dhe personat të cilëve u është dhënë mbrojtje plotësuese ose e përkohshme në Lituani nuk kanë të drejtën e bashkimit familjar.

Mund të ketë një periudhë pritjeje prej jo më shumë se tre vitesh ndërmjet paraqitjes së aplikimit për bashkim familjar dhe lëshimit të lejes së qëndrimit për pjesëtarët e familjes. Kushtet për paraqitjen e aplikimit të të huajve për bashkim familjar dhe procedura e shqyrtimit përcaktohet nga Ministri i Brendshëm.

8. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor

Sipas Rezolutës Nr. 230 për Miratimin e Përshkrimit të Përgjithshëm të Procedurës së Sigurimit Shëndetësor për të Huajt, të huajt të cilët do të vizitojnë Republikën e Lituani ose do të aplikojnë për Leje Qëndrimi të Përkohshme në Republikën e Lituani, duhet të kenë një Kontratë (policë) Sigurimi Shëndetësor.

http://www3.lrs.lt/pls/inter3/dokpaieska.showdoc_l?p_id=252667

Ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor që arrijnë në 3 për qind të pagave të personave që punojnë sipas një kontrate pune ose që janë në pozicione drejtuese.

Pjesa më e madhe e institucioneve të kujdesit shëndetësor personal janë institucione publike jo-fitimprurëse. Ato ndihmohen nga autoritetet vendore, kontetë ose Ministria e Shëndetësisë. Burimi kryesor i financimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor është Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Detyrueshëm. Ka sigurim shëndetësor të detyrueshëm dhe vullnetar. Sigurimi shëndetësor i detyrueshëm organizohet nga institucionet e mëposhtme: Këshilli i Sigurimit të Shëndetësor Detyrueshëm, Fondi i Pacientëve Shtetërorë në Ministrinë e Shëndetësisë, fondet rajonale të pacientëve.

Personat që mbulohen nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm janë shtetas lituanëzë, të vendeve anëtare dhe shtetas të vendeve të treta, të cilët qëndrojnë në mënyrë të përhershme në Lituani, si dhe shtetas të vendeve të tjera anëtare ose të vendeve të treta që jetojnë përkohësisht në Republikën e Lituani, nëse ata janë punësuar në mënyrë të ligjshme në Republikën e Lituani dhe të miturit në familjet e tyre.

Shërbimet e mëposhtme të kujdesit shëndetësor paguhen nga buxheti i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Detyrueshëm: ndihmë mjekësore parandaluese, ndihmë mjekësore, rehabilitim mjekësor, infermieri, shërbime sociale dhe shërbime për kujdesin shëndetësor personal, si dhe analiza të shëndetit personal.

Shikoni gjithashtu <http://www.euro.who.int/Document/E69920.pdf>

9. Sistemi i sigurimit shoqëror

Sistemi i sigurimit shoqëror në Lituani përbëhet nga sistemi i sigurimit shoqëror, sistemi i sigurimit mjekësor dhe sistemi i mbështetjes sociale. Aktualisht, të gjithë punonjësit sigurohen në mënyrë të detyrueshme. Ligji parashikon që punëdhënësit të paguajnë ose të mbajnë kontributet e plota në emër të punonjësve të tyre. Për më tepër, ligji përcakton gjithashtu sigurimin shoqëror vullnetar.

Sigurimi Shtetëror Shoqëror dhe Mjekësor është i detyrueshëm për personat e vetë-punësuar:

- 1) pronarët ose qiramarrësit e sipërmarrjeve personale;
- 2) anëtarët e shoqërive të përgjithshme dhe të kufizuara;
- 3) juristët dhe ndihmës juristët;
- 4) noterët;
- 5) personat që punojnë me një patentë të taksueshme;
- 6) bujqit dhe personat e rritur që punojnë në ferma.

Individët e përkohshëm më sipër duhet të paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimit shoqëror për veten e tyre, të ndryshme nga ato që paguhen mbi bazën e punësimit, në shumën e përcaktuar me ligj.

Individët e siguruar kanë të drejtë të marrin përfitimet e mëposhtme sipas sistemit të sigurimit shoqëror dhe mjekësor:

- 1) pensionet për pleqërinë;
- 2) pensionet për aftësi të kufizuara;
- 3) pensionet për vejanët/vejushat ose jetimët;
- 4) pagesat për sëmundje ose aftësi të kufizuara të përkohshme;
- 5) pagesat për lejet e lindjes për nënat dhe baballarët;
- 6) shërbimet mjekësore;
- 7) ndihmën për papunësinë;
- 8) kompensimin për aksidente në punë (kompensimin për sëmundje që vijnë si pasojë e një aksidenti ose sëmundjeje në punë; një pagesë të vetme kompensimi për dëmtim në punë; ose pagesa periodike kompensimi për dëmtim në punë);
- 9) ndihmën për varrime.

Sistemi shtetëror i sigurimit shoqëror përbëhet nga programe të sigurimit shoqëror dhe përkrahje sociale të krijuara për të vijuar përkrahjet që siguroheshin nga sistemi sovjetik. Sigurimi shoqëror përfshin pensionet për pleqërinë; pensionet për të mbijetuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara; kompensimin për papunësinë; ndihmën për shtatëzaninë, lindjen dhe fëmijën, një lloj përkrahjeje sociale dhe kujdesi mjekësor falas.

Për të përfituar pension për pleqërinë, një punonjës mashkull duhet të jetë paktën 60 vjeç dhe të ketë të paktën 25 vjet punë. Një femër duhet të jetë 55 vjeç dhe të ketë të paktën 20 vjet punë. Kjo kategori përfituesisht nuk përfshin vetëm punëtorët e fabrikave dhe institucioneve shtetërore, por edhe bujq dhe punëtorë fermash.

Programi i përfitimeve shoqërore financohet nga organet e qeverisjes vendore. Ai përfshin pagesa për gratë gjatë shtatëzanisë dhe lindjes së fëmijës si dhe për shpenzimet pas lindjes. Programi ka pagesa unike për çdo fëmijë të sapolindur, si dhe pagesa për fëmijët për prindërit e vetëm apo familjet. Këto pagesa vazhdojnë deri në kufijtë e moshës së përcaktuar me ligj. Shteti gjithashtu mban një numër jetimoresh, senatoriumesh dhe shtëpish për të moshuarit.

Pavarësisht shërbimit ambulator dhe kujdesit efikas të urgjencës, shërbimet dhe ambientet mjekësore në Lituani vuajnë nga një mungesë pajisjesh dhe mjekimesh, si dhe nga plogështia në funksionimin dhe administrimin e shërbimeve shëndetësore. Sistemi është në pronësi të shtetit dhe i drejtuar po nga shteti.

Ministry of Social Security and Labour (Ministria e Sigurimit Shoqëror dhe Punës)

A. Vivulskis str. 11

LT-2693 Vilnius

Lithuania

Tel. + 370 2 652 283

Fax + 370 2 652 463

post@socmin.lt

<http://www.socmin.lt>

10. Strehimi

Kontaktet personale dhe ndihma e miqve, kolegëve, të njohurve, të afërmeve apo partnerëve të biznesit janë disa prej mënyrave për të gjetur ambient të përshtatshëm strehimi.

Informacioni për marrjen me qira apo blerjen e pronave të patundshme mund të gjendet në njoftimet e specializuara në gazeta, si në ato të përditshme, ashtu edhe në shtypin lokal. Nga ana tjetër, ju mund të vendosni edhe njoftimin tuaj personal që përcakton se çfarë lloj banese kërkon.

Nëse dëshironi të merrni me qira apo të blini një shtëpi, ju mund të kërkonit shërbimet e agjencive të pronave të patundshme të cilat do të kërkojnë një komision. Informacion në lidhje me agjentët e pronave të patundshme mund të gjeni në 'Geltonieji puslapiai' (Faqet e Verdha) dhe në seksionet e njoftimeve të gazetave. Pjesa më e madhe e agjentëve të pronave të patundshme kanë faqe elektronike me përshkrime të detajuara dhe fotografi të banesave në shitje.

Zakonisht agjentët e udhëtimit mund të ofrojnë këshilla dhe informacion për gjetjen e banesave.

11. Njohja e diplomave

Njohja akademike

Institucioni për vlerësimin e kualifikimeve të huaja që jep të drejtën për shkollimin e lartë (vlerësimi i arsimit të mesëm) dhe vlerësimin e kualifikimeve të arsimit të lartë është Qendra për Cilësinë dhe Vlerësimin e Studimeve. Njohja kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës mbi bazën e vlerësimit nga Qendra për Cilësinë dhe Vlerësimin e Studimeve. Vlerësimi dhe njohja e kualifikimeve të mesme të huaja zakonisht nuk kërkon më shumë se 4 muaj. Vlerësimi dhe njohja e kualifikimeve të huaja është kusht për pranimin në institucionet e arsimit të lartë në Lituani.

Centre for Quality Assessment in Higher Education (Qendra për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë)

Suvalku g. 1,
LT-03106 Vilnius
fax (+370 5) 213 25 53
e-mail: skvc@skvc.lt
Ms Zivile Stankeviciene, tel. +370 5 210 47 72, zivile@skvc.lt
<http://www.skvc.lt>

Shikoni gjithashtu <http://www.enic-naric.net/index.aspx?c=Lithuania>

12. Shërbimet mbështetëse që u ofrohen migrantëve

Lithuanian Centre for Human Rights (Qendra Lituanëze për të Drejtat e Njeriut)

A. Smetonos g. 2/11
Vilnius LT-01115
tel. (8 5) 262 88 58
faks. (8 5) 262 89 60
info@lchr.lt
<http://www.lchr.lt>

Centre for Civic Initiatives (Qendra për Iniciativat Qytetare)

Pilietinių iniciatyvų centras
A. Smetonos g. 5, 304 kab.
LT-01115 Vilnius
Tel.: (8-5) 212 44 18,
Fax.: (8-5) 232 42 37,
pic@pic.lt

Lithuanian Red Cross (Kryqi i Kuq Lituanëz)

Gedimino pr. 3A
01103 Vilnius
Tel: +370 5 2628037
Fax: +370 5 2619923
E-mail: info@redcross.lt

IOM Mission in Vilnius (Misioni i ONM në Vilnius)

Jaksto 12, 4th Floor
LT-01105 Vilnius
Tel. +370-5-261-0115
Fax. +370-5-261-1326
Pyetje të përgjithshme: iomvilnius@iom.lt
Faqja elektronike: www.iom.int/lithuania/

13. Marrja e nënshtetësisë

Nëpërmjet lindjes

Një fëmijë, në rastin kur të dy prindërit në momentin e lindjes së tij janë shtetas lituanëzë, do të jetë shtetas i Republikës së Lituaniës pavarësisht nëse ai/ajo ka lindur brenda apo jashtë territorit të Lituaniës.

Nëse prindërit e fëmijës kanë shtetësi të shteteve të ndryshme dhe në momentin e lindjes së fëmijës njëri prej prindërve është shtetas lituanez, fëmija do të jetë shtetas i Republikës së Lituanisë nëse ai/ajo ka lindur në territorin e Lituanisë.

Nëpërmjet natyralizimit

Një person mund të natyralizohet nëse ai ka jetuar në Lituani për të paktën 10 vjet, ka një leje qëndrimi të pakufizuar, ka kaluar një test zyrtar gjuhe, ka kaluar një provim mbi dispozitat bazë të Kushtetutës, ka bërë betimin për besnikëri ndaj Republikës së Lituanisë dhe është në gjendje të përballojë kostot e jetesës së tij.

Shtetësia e dyfishtë është një rast i veçantë në Lituani dhe personat që janë të gatshëm të marrin nështetësi dhe pasaportë lituaneze, duhet të heqin dorë nga nënshtetësia e tyre aktuale dhe t'ia vërtetojnë këtë fakt autoriteteve lituaneze për migracionin.

Nëpërmjet martesës

Bashkëshortët e shtetasve lituanezë, të cilët kanë qenë të martuar për 7 vitet e fundit ndërkohë që kanë qëndruar në Lituani, mund të marrin nështetësinë e Republikës së Lituanisë.

Shikoni gjithashtu Ligjin për Nënshtetësinë http://www3.lrs.lt/pls/inter3/dokpaieska.showdoc_l?p_id=285786

14. Kontakte dhe informacion tjetër i nevojshëm

Ambasada Shqiptare në Poloni (që mbulon Lituanië)

ul. Altowa 1, 02-386 Warsaw, Poland

Tel: (48 22) 824 14 27

Fax: (48 22) 824 14 26

E-mail: alb@atos.warman.com.pl

Ambasada e Bonje-Hercegovinës në Danimarkë (që mbulon Lituanië)

H.C. Andersen's Boulevard 48 2tv, 1553 Copenhagen V, Denmark

Tel: (45 33) 32 80 42, (45 33) 33 80 40,

Fax: (45 33) 33 80 17

E-mail: info@embassy.bh.dk

Faqja elektronike: <http://www.embassybh.dk>

Ambasada Kroate në Suedi (që mbulon Lituanië)

Birger Jarlsgatan 13, 1st fl., 111 45 Stockholm, Sweden

Tel: (46 8) 678 8310

Fax: (46 8) 678 8320

E-mail: croemb.stockholm@mvp.hr

Ambasada e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në Poloni (që mbulon Lituanië)

ul. Krolowej Marysienki 40, 02-954 Warsaw, Poland

Tel: (48 22) 651 72 91, (48 22) 651 72 92

Fax: (48 22) 651 72 92

E-mail: ambrmwar@zigzag.pl

Faqja elektronike: <http://www.ambasadarm.zigzag.pl>

Ambasada Serbe në Poloni (që mbulon Lituanië)

Al. Ujazdowskie 23/25, 00-540 Warsaw, Poland

Tel: (48 22) 628 61 51, (48 22) 625 60 41, (48 22) 625 60 52, (48 22) 628 34 16 (Sekretaria e Ambasadorit),

(48 22) 628 51 61 (Seksioni Konsullor)

Fax: (48 22) 629 71 73

E-mail: yuabapl@zigzag.pl